



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT
DEPARTAMENTI I AKUAKULTURES DHE PESHKIMIT

MIRATOI

DEKANI

Prof. Dr. Ilir Kristo



Rregullore e Brendshme e Programit te Studimeve Profesionale 2 vjeçare

“Teknologjite e Akuakulturës dhe Peshkimit”

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc. Dr. Rigers Bakfu

Tiranë 2022

Kreu I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kuadri ligjor

Rregullore e Programit te Studimeve Profesionale 2 vjeçare "Teknologjë e Akuakulturës dhe Peshkimit" ofruar nga "Departamenti i Akuakultures dhe Peshkimit" bazohet në:

- 1 Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në republikën e shqipërisë";
- 2 Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës (Neni 59);
- 3 Rregullorja e studimeve e Universitetit Bujqësor të Tiranës (Neni 49);
- 4 Rregullorja e brendshme e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit;
- 5 Rregullorja e brendshme e Departamentit të Peshkimit dhe Akuakultures

Neni 2

Qëllimi i rregullores;

- 1 Rregullorja përcakton rregullat për mësimin dhe vlerësimin e studentëve, hartimin dhe përmirësimin e programeve mësimore, mbështetjen e studentëve, si dhe kornizën për sigurimin e cilësisë.

Neni 3

Misioni në mësimdhënie;

- Garanton mundësi per rritjen e kapaciteteve profesionale ne fushen e akuakultures dhe peshkimit, ne permbushje te kerkesave te tregut te punes per teknike te larte qe do te punesohen ne sektoret e Ekonomise Blue.
- Pas perfundimit te studimeve 2-vjecare, studentet do te mund te punojne prane fermave te akuakultures te ujerave te brendshme, bregdetare dhe detare, industrine e perpunimit te produkteve peshkore dhe portet e peshkimit.

Neni 4

Organizimi i vitit akademik

1. Viti akademik organizohet në dy semestra, me 15 javë secili. Ngarkesa javore në auditor e studentit varion në kufijtë 20-25 orë mësimore 50 minutëshe në javë. Çdo semestër përfshin jo më pak se 28 ECTS;

Neni 5

Organizimi i programit të studimit

Ky program i ciklit të pare është i organizuara në 2 vite akademike dhe përfshin 120 ECTS;

- Programi i studimit përfshin module të detyrueshme dhe me zgjedhje;
- Studentët diplomohen me provim formimi të përgjithshëm përfundimtar. Departamenti harton programin e provimit të formimit, i cili miratohet nga Dekani;
- Në përfundim të programit të ciklit të parë, lëshohet diploma: Program Studimi Profesional 2-Vjecar, "Teknologjite e Akuakultures dhe Peshkimit".

KREU II

2.1. STRUKTURA E PROGRAMIT TË STUDIMIT PROFESIONAL 2-VJECAR, "TEKNOLOGJITE E AKUAKULTURES DHE PESHKIMIT"

Neni 6

Kreditet sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS)

1. Krediti i formimit të arsimit të lartë i referohet ECTS-së dhe shpreh volumin e punës mësimore përritjen e rezultateve të pritshme mësimore.
2. Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.
3. Vëllimi mesatar i punës së kryer gjatë një viti studimesh, me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1500 (njëmijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.
4. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 (njëmijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.
5. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm përvlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre.
6. Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të fituara nga një student në një program tjetër studimi, me qëllim vazhdimin e studimeve profesionale 2-vjecar, "Teknologjite e Akuakultures dhe Peshkimit", bëhet nga Departamenti, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në Rregulloren e Studimeve të UBT.

Neni 7

Objektivat formues dhe kompetencat profesionale

1. *Objektivat formuese të programit* synojnë të përgatisin një teknik te larte të formuar në fushën e akuakulturës dhe peshkimit, të aftë që:
 - a) Të shqyrtojë te gjitha metodat e rritjes se prodhimeve te akuakultures se ujerave te brendshme dhe detare, sebashku me gjithe nacionet e lidhura me menaxhimin e peshkimit, ne zbatim te politikave kombetare dhe atyre nderkombetare, sia ajo e Komisionit te Pergjithshem te Peshkimit ne Mesdhe dhe Detin e Zi (GFCMes) dhe Bashkimit Evropian.
 - b) Të ketë njohuri të qëndrueshme për sistemet e akuakultures, qe mund te istalojen ne ujerat e brendshme dhe ato detare dhe per te maksimizuar prodhimtarin prej tyre ne nje zone te kufizuar dhe te kontrolluar dhe ne respekt te mjedisit ujor. Gjithashtu studentet do te marrin njohuri te qendrueshme dhe ne fushen e peshkimit te pergjegjshem per te ruajtur shume nga speciet detare qe sot i kercenojet ekzistencia.
 - c) Të aplikojë njohuritë e fituara ne auditor në situata konkrete dhe interpretojnë drejt teknologjë e kultivimit, të aplikuara në përputhje me mjedisin ujor qe do te aplikohen dhe gjithashtu në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin në fushën e akuakultures dhe peshkimit.
 - d) Ti transmetojë, apo komunikojë njohuritë dhe aftësitë e fituara, fermerëve, sektorit publik si dhe grupeve të tjera të interesit në sektorin e akuakultures, peshkimit, sigurisë ushqimore dhe zhvillimin rural.
 - e) Të përdorë njohuritë dhe aftësitë profesionale të fituara për vetpunësim, përmes: (i) krijimit të sipërmarrjes prodhuese, në formën e fermës së akuakultures; si dhe (ii) krijimin e organizatave jo fitimprurësë (OJF) të orientuara në fushën e akuakultures dhe peshkimit.
 - f) Të vazhdojë të mësojë dhe fitojë aftësi e kompetenca të tjera plotësuese krahas punës përmes trajnimeve dhe përvojës në ushtrimin e profesionit.
2. Kompetencat profesionale janë:
 - a) Ne shkencat biologjike fondamentale: Njohuri mbi Matematikën, Kiminë, Biokiminë, Fiziologjinë dhe Biologjinë e peshqve.
 - b) Disiplinat shkencore të lidhura me akuakulturen. Ata do të janë të aftë për të përvetësuar mënyrat e riprodhimit të peshqve, Mikrobiologjinë dhe Toksikologjinë Akuatike,

Majmërinë e Peshqve, Teknologjë e Akuakulturës, Statistika dhe Informatika për Akuakulturën dhe Peshkimin, prodhimin e ushqimeve me originë bimore duke filluar nga teknikat e kultivimit, rritjes, mbrojtjes nga sëmundjet.

- c) Ekspertizë këshillimi apo asistence profesionale (consulting si specialist i pavaruar ose nën drejtimin e specialistit të nivelit të lartë), për fermerët, për sigurinë dhe vetylësimin e cilësisë së prodhimit primar në fermat akuakultures, qendrat e perpunimit te produkteve peshkore apo edhe sektore te tjere te lidhur me peshkimin.
- 3. Bazuar në kompetencat profesionale që ata do të marrin gjatë ciklit të studimeve, ata mund të punësohen si specialistë:
 - a) Në fermat vetjake te akuakulturës, për të ndjekur proceset nga rritja e te vegjëlve deri te dalja e produktit ne treg;
 - b) Në ferma të mëdha te akuakulturës detare për ndjekjen dhe zbatimin e hallkave teknolgjike të prodhimit te peshqve dhe molusqeve bivalve (midhjeve);
 - c) Autoriteti Kombetar i Ushqimit – AKU, si vleresues i cilesise se produkteve te peshkimit ne terren;
 - d) Ndermarrjet e perpunimit apo konservimit ne zonat bregdetare apo Elbasan
 - e) Fermat e akuakultures te ujerave te brendshme (troftikulture apo krapikulture)
 - f) Fermat bregdetare apo detare (kultivimi me kosha notues apo mitikultura)
 - g) Teknike te ndryshem nen autoritetet e Ministrive te linjes (si monitorues se llojeve ne zhdukje, sasise se peshkuar, llojeve te lejuara dhe dimensionet e lejuara te rrjetave)
 - h) Asisten laborant per vleresimin e cilesise se produkteve te peshkimit ne laboratore te agjensive mjedisore
 - i) Teknike te kontrollit ne fabrikat e konservimit te produkteve te peshkimit
 - j) Anetare te organizatave te menaxhimi te peshkimit (OMP) te zonave bregdetare apo prane liqeneve te medha natyrore
 - k) Organizata Jo-Fitimprurese me fokus zhvillimin e sektoreve te Ekonomise Blu dhe ruajtjen e biodiversitetit ujor.

Neni 8

Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit.

1. Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një programin e studimit, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:
 - a. *mësim në auditor*, si leksione, seminare, lëndë individuale, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;
 - b. *studim individual*, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
 - c. përgatitje për provime;
 - d. përgatitje për provimin e diplomës;
 - e. *veprimtari të tjera*, si praktika profesionale pranë subjekteve publike ose private.
2. Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, lëndë individuale, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secili modul.
 - a. Frekuentimi i veprimtarive formuese (leksione, seminare, ushtrime, punë laboratorike) është i detyrueshëm në masën 80% te studimeve profesionale 2-vjeçare "Teknologjite e Akuakulturës dhe Peshkimit". Studentët, të cilët nuk plotësojnë këtë masë frekuentimi, humbasin të drejtën për të zhvilluar provimin në atë modul-disiplinë. Studenti e rifiton këtë të drejtë në vitin akademik pasardhës duke plotësuar pjesën e mbetur të frekuentimit.
 - b. Struktura mësimore dhe plani mësimor, hartohen në fillim të çdo viti akademik dhe miratohen nga Dekani i FBM. Plani mësimor përfshin, modulet, raporti teori-praktikë, numri i ECTS. Mbi bazën e planit mësimor hartohet orari mësimor.
 - c. Programet mësimore hartohen për çdo modul, sipas modelit të VKM Nr. 41, datë 24. 01. 2018 "Për elementët e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë. (Aneksi 1);
 - d. Programet hartohen nga titullari i modulit ose grup pedagogësh, shqyrtohen në departament dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe Dekani i FBM.
 - e. Pedagogu harton planin kalendar, në pëpruthje me programin e modulit në fillim të çdo semestri. Plani kalendar mund të përfshihet dhe në programin e modulit.

Neni 9

Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë Programin Bachelor

- 1 Programi i studimeve profesionale 2-vjeçare “Teknologjite e Akuakulturës dhe Peshkimit” përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS.
- 2 Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:
 - a. *Lëndë bazë të programit të studimit (kategoria A)*, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme dhe përfshijnë rreth 15 % ECTS;
 - b. *Lëndë karakterizuese (B)*, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij dhe përfshijnë 50 %; ECTS;
 - c. *Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese (C)* në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje dhe përfshijnë 20 % ECTS;
 - d. *Lëndë plotësuese (D)*, të fokusuarë në përfthimin e aftësive aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim dhe përfshijnë 14 % ECTS;
 - e. *Detyrime përmbyllëse (E)*, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar dhe përfshijnë rreth 1 % ECTS.
- 3 Veprimtaritë formuese mund të janë:
 - a. të detyrueshme;
 - b. të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara në kurikulën e Programi të Studimit.

Neni 10

Plani mësimor

- 1 Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen:
 - a. lëndët e programit të studimit, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra;
 - b. kreditet përkatëse.

Neni 11

Kuotat e pranimit dhe grupet mësimore

1. Departamenti i propozon Dekanit të FBM-së kuotat e lira për regjistrimet e reja të studentëve, sipas përcaktiveve në rregulloren e UBT-së dhe FBM-së.
2. Kurset dhe grupet mësimore:
 - a. Mësimi zhvillohet mbi bazë grupe e kursi. Grupi përbën formacionin bazë me të cilin realizohen të gjitha format e punës mësimore. Si rregull, numri i studentëve në seminar është 35, në laboratore është 25 dhe në praktika 25. Numri i studentëve në leksion është deri në 6 grupe seminari;
 - b. Kursi përbën një formacion më të gjerë ku përfshihen disa grupe mësimore me të cilët zhvillohen vetëm leksionet me program të njëjtë të lëndës.
 - c. Ndarja e studenteve në grupe evidentohet në regjistrat e vitit akademik.
 - d. Në fillim të çdo viti të ri akademik, sekretaria mësimore bën regjistrimin e studentëve, në vitet pasardhëse, nëse ata kanë fituar numrin minimal të krediteve të përcaktuar në rregulloren e studimeve të UBT dhe paguajnë tarifën e shkollimit;

Neni 12

Programi lëndor (syllabus-et)

- 1 Modeli i programit të lëndës, që përdoret për hartimin e syllabus-eve, përmban të gjithë elementët sipas përcaktiveve dhe modeleve në fuqi (Aneksi 1).
- 2 Programi mësimor i modulit hartohej nga titullari i modulit, ose grup lektorësh, konsultohet në njësinë bazë përgjegjëse për programin përkatës të studimit dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe dekani fakultetit. Pjesë e programit të modulit është dhe plani kalendar.

Neni 13

Diploma dhe suplementi

- 1 Diplomat, që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, shoqërohen me suplementin e diplomës.

- 2 Suplementi i diplomës është hartuar në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe përshkruan natyrën, nivelin, përbajtjen dhe rezultatet e studimeve që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit (Aneksi 4).

Neni 14

Orari mësimor

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohen në orarin e mësimeve, i cili hartohet nga FBM në fillim të çdo semestri dhe shpallet nga sekretaria mësimore një javë para fillimit të mësimit. Orari është i detyrueshëm të respektohet nga studentët dhe pedagogët.

Neni 15

Regjistri i pedagogut

- 1 Regjistri i pedagogut është dokument zyrtar ku evidentohet zhvillimi i orëve të mësimit nga pedagogët.
- 2 Rregjistri i pedagogut është dokument shtetëror bazë për të evidentuar frekuentimin dhe rezultatet e studentit. Çdo pedagog është i detyruar të shënojë në regjistër emërtimin e disiplinës, veprimtaritë formuese të zhvilluara, të pasqyrojë saktë mungesat dhe rezultatet e studentëve.
- 3 Regjistri i pedagogut është dokumenti zyrtar që vërteton ngarkesën e përballuar nga pedagogu në sistemin me kohë të plotë.
- 4 Regjistri i pedagogut kontrollohet dhe vërtetohet nga përgjegjësi i departamentit.
- 5 Ky dokument ruhet dhe një fotokopje e tij dorëzohet në department dhe njësitë përgjegjëse të fakultetit/universitetit për të vërtetuar kryerjen e procesit mësimor, si dhe përfshirja në rast të tejkalimit të normës.

KREU III

KONTROLLI I DIJEVE DHE INSTRUMENTET E VLERËSIMIT

Neni 16

Format e vlerësimit

- 1 Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: (a) vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit, si dhe (b) vlerësimi përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit përfaqëson deri në 40% të vlerësimit total. Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/pedagogët në programin e modulit dhe miratohet para fillimit të çdo viti akademik nga përgjegjësi i departamentit. Studentët duhet të njoftohen nga pedagogu i modulit, që në fillim të semestrit, për raportin që zë vlerësimi vjetor ndaj vlerësimit të përgjithshëm të vitit akademik në fillim te semestrit.

Neni 17

Mënyrat e kontrollit të dijeve

- 1 Mënyrat e kontrollit të dijes (provim ose kolokium) përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve.
- 2 Provimi është forma kryesore për vlerësimin e dijeve të përvetësuara nga studenti gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të modulit-disiplinës.
 - a. Kontrolli i dijeve bëhet:
 - b. me shkrim;
 - c. me gojë, ose
 - d. I kombinuar.
- 3 Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eleminuese. Mënyra e organizimit të provimit është në funksion të natyrës së disiplinës. Ai përcaktohet nga pedagogu titullar i lëndës, mbështetur në programin e lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit.
- 4 Modalitetet e organizimit të kontrollit të dijeve, shprehen në programin e lëndës dhe i bëhen të njoitura studentit në fillim të vitit/seimestrit ku zhvillohet moduli.
- 5 Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë.
- 6 Në formën e kontrollit me shkrim, provimet bëhen të sekretuara.

Neni 18

Parakushtet për hyrje në provim

- 1 Studenti ka të drejtë të paraqitet në provimin e një lënde/moduli kur ka ka plotësuar kriteret detyruese të vendosura për atë lëndë (detyrat, projektet, masën e frekuentimit të elementeve mësimorë), të parashikuara në planin mësimor dhe në masën e përcaktuar në këtë rregullore dhe atë të FBM-së.
- 2 Elementët e kontrollit të dijeve dhe masa e tyre në % janë parashikuar në rregulloren e FBM dhe shprehen në programet e çdo moduli. Ato janë: pjesëmarrja në leksione dhe seminare (10%); testimet e ndërmjetme (20%), detyrë kursi (10%), provim përfundimtar (60%).
- 3 Kontrolli i dijeve për modulin përkatës realizohet në dy faza:
 - a. Kontrolli i fazës së parë përfshin kontrollin gjatë procesit mësimor, ku kontrolli i dijeve realizohet përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentit në leksione, seminare, ushtrime, punët laboratorike, detyrat me shkrim (provimet ndërmjetëse), detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikën mësimore etj.
 - b. Pavarësisht sasisë së pikëve të realizuara, studenti që ka munguar apo është vlerësuar negativisht në detyrat e kursit, projekte kursi, apo në praktikën mësimore, është i detyruar t'i shlyejë ato në javën e fundit të zhvillimit të procesit mësimor. Nëse vlerësohet negativisht, ai humbet të drejtën e hyrjes në provim.
- 4 Studentët që kanë humbur të drejtën e hyrjes në provim për shkak të mosrealizimit të detyrës apo projektit të kursit kanë të drejtë të bëjnë shlyerjet e tyre ne muajin shtator, sipas grafikut të vendosur nga Dekanati.
- 5 E lejon grafiku i ndërvarësisë së lëndëve.
- 6 Ka paguar tarifën e shkollimit.

Neni 19

Sezonet e Provimeve dhe riprovimeve

- 1 Provimet zhvillohen brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik. Datat e tyre propozohen nga sekretaritë mësimore në bashkëpunim me departamentet, miratohen nga Dekani dhe shpallen jo më vonë se katër javë para fillimit të sezonit.

2 Provimet zhvillohen në këto sezone:

- sezoni i provimeve të dimrit, i cili zhvillohet pas përfundimit të semestrit të pare;
 - sezoni i provimeve të verës, i cili zhvillohet pas përfundimit të semestrit të dytë;
 - sezoni i provimeve të vjeshtës, i cili zhvillohet në muajin shtator;
 - Sezonet plotësuese (një javë në muajin Janar dhe një javë në muajin Prill). Të drejtën për të hyrë në provim në sezone plotësuese, e ka studenti që mbart provime nga viti/vitet paraardhëse, pasi ka kryer regjistrimin, sipas rregullave.
- 3 Nëse studenti nuk ka shlyer detyrimet e lëndës në kohën normale të zhvillimit të saj, ai duhet t'i shlyejë ato para fillimit të sezonit të provimeve, në periudhën e shpallur nga Dekani.
- 4 Studenti, nuk lejohet të hyjë më shumë se një herë në provimin e një lënde, brenda një sezoni. Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në lëndë të ndryshme.
- 5 Afatet e përcaktuara për provimet dhe riprovimet janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët, ashtu dhe nga studentët
- 6 Për studentët përsëritës të sistemit Bachelor, ridhënia e provimeve për modulet e pashlyera, bëhet gjatë vitit në vazhdim në sezonet e rregullta dhe sezonin e vjeshtës.

Neni 20

Organizimi i Provimeve

1. Provimet zhvillohen në datën, auditorin dhe orën e caktuar, të cilat reflektohen në grafikun e provimeve, të shpallur katër javë, para fillimit të sezonit.
2. Në raste të jashtëzakonshme, për arsyen madhore, në pamundësi të zhvillimit të provimit ditën e caktuar, dekani, me urdhër me shkrim, e anullon dhe cakton një datë të mëvonshme e cila u bëhet e njohur studentëve. Për çdo vendim të tillë dekani njofton Rektoratin. Provimet organizohen mbi bazë kursi ose grupi mësimor.

Neni 21

Komisionet e provimeve

1. Komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Zv. Dekanin për mësimin dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim, ose kur përgjegjësi i departamentit e gjykon, ai përcakton pedagogun

që do ta zëvendësojë, sipas rregullave të këtij paragrafi. Në rast pamundësie zëvendësimi, me propozim të dekanit dhe miratim të Rektorit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda 5 ditëve nga përfundimi i tij.

Neni 22

Zhvillimi i provimit

- 1 Përgjegjësi i Departamentit merr masat e nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e provimeve konform rregullave të përcaktuar në këtë rregullore dhe Rregulloren e brendshme të FBM.
- 2 Provimet zhvillohen në orën, datën dhe auditorin e caktuar nga sekretaria mësimore, të cilat reflektohen në orarin e provimeve, të shpallur katër javë para fillimit të sesionit.
- 3 Në raste të jashtëzakonshme, në pamundësi të zhvillimit të provimit ditën e caktuar, Dekani, me urdhër me shkrim, e anullon dhe cakton një datë të mëvonshme brenda sezonit apo jashtë tij, e cila u bëhet e njojur studentëve.
- 4 Komisioni i provimit të një lënde përbëhet nga jo më pak se dy anëtarë: titullari i lëndës dhe pedagogë të tjera të përfshirë në mësimdhënien e lëndës. Nëse lënda është zhvilluar nga një pedagog, përgjegjësi i departamentit cakton një anëtar tjetër të stafit akademik të afërt me atë disiplinë. Nëse titullari i lëndës ose pedagogët e përfshirë në mësimdhënie, për arsy madhore nuk mund të marrin pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit cakton, me shkrim, pedagogët që do ti zëvendësojnë dhe njofton Dekanin.
- 5 Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të personelit të Universitetit, me përjashtim të drejtuesit të departamentit, e persona të tjera të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori për të kryer kontroll.
- 6 Studenti është i detyruar të paraqitet në provim me librezën e studentit. Në të kundërt ai nuk lejohet të futet në provim dhe pasojat rëndojnë mbi studentin. Në përfundim të provimit, komisioni plotëson librezen e studentit me notën e vlerësimit me numër e me fjalë, duke u firmosur nga çdo anëtar i komisionit.
- 7 Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve. Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme, përjashtohet nga provimi.
- 8 Provimet me shkrim bëhen të sekretuar dhe zgjasin deri 2 orë. Pas dhënisë së tezës në provimin me shkrim nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjera të grupit apo kursit përkatës.
- 9 Gjatë provimit mund të lejohet përdorimi i mjeteve ndihmëse. Sistemi i pikëve dhe konvertimi përkatës me notë, që përdoret në provimin me shkrim, i bëhet i njojur studentit para fillimit të provimit.

- 10 Kohëzgjatja e një provimi me gojë është jo më shumë se 30 minuta për çdo student.
- 11 Anëtarët e komisionit të provimit të disiplinës mbikëqyrin zhvillimin korrekt të provimit gjatë gjithë kohës nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit.
- 12 Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës, firmosën nga anëtarët e komisionit të provimit dhe miratohen e nënshkruhen nga përgjegjësi i departamenti
- 13 Për çdo provim hartohen teza alternative dhe zgjedhja e tezës që u jepet studentëve bëhet në prani të komisionit te provimit nga studentet;
- 14 Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet ndërrim teze.

Neni 23

Ndërprerja e Zhvillimit të provimit

1. Provimi nderpritet kur studenti kërkon t'i imponohet, ose të kërcënojë me forma të ndryshme anëtarët e komisionit.
2. Kur ndaj anëtarëve të komisionit të provimit ushtrohet dhunë nga studenti (apo nga ndonjë person tjeter i porositur prej tij), në këto raste kërkohet ndihma autoriteteteve drejtuese të Departamentit dhe Fakultetit dhe nëse është e nevojshme deri tek organet e ruajtjes së rendit publik për rivendosjen e kushteve normale të zhvillimit të provimit.

Neni 24

Rezultatet e provimeve

- 1 Studenti, që për çfarëdo arësyen nuk paraqitet në provimin (me shkrim apo me goje) e një disipline, humbet të drejtën e provimit dhe konsiderohet mbetës për atë disiplinë në atë sezon. Gjithashtu, studenti vlerësohet mbetës kur:
 - a. Nuk është përgatitur;
 - b. Tërhiqet nga provimi;
 - c. kopjon ose mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast përjashtohet nga provimi);
 - d. Pengon zhvillimin e rregullt të provimit ose të kolokiumit përjashtohet nga provimi ose kolokumi).

- 2 Studenti nuk lejohet të mbrojë diplomën, në qoftë se nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e vitit të fundit si dhe ato të mbartura.
- 3 Studenti merr vlerësimin kalues në një lëndë kur:
 - a. ka plotësuar të gjitha parakushtet e përcaktuara sipas programit mësimor;
 - b. vlerësohet me notë kaluese sipas formës së kontrollit që parashikon programi.
- 4 Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Nota kaluese më e ulët është nota 5 (pesë).
- 5 Nga 1 deri ne 44 pikë vlerësimi përfundimtar është nota 4 (kater).
- 6 Kur studenti arrin të grumbullojë 45 pikë në vlerësimin total, (dmth vlerësimi i vazhduar + vlerësimi në provimin përfundimtar), vlerësohet kalueshëm.

Neni 25

Shpallja e rezultateve të provimit

- 1 Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda ditës kur provimi është me gojë dhe brenda 10 ditëve (të punës) nga data e kryerjes së provimit, kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë.
- 2 Pas shpalljes se rezultateve (hedhjes së tyre në sistem) studentët kanë detyrimin e leximit të notës së tyre në sistem dhe kontestimit të mundshëm të notës brenda dy ditëve (48 orë). Në të kundërt nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të proces verbalit në system brenda dy diteve. Pas 14 diteve (nga data e provimit) sistemi nuk gjeneron më process verbalin për atë modul.
- 3 Në rastet e hedhjes së gabuar të notave/notës nga ana e komisionit, në lidhje me vlerësimin e studentit, komisioni ka detyrimin të verifikojë dhe bëjë korektimin vetëm brenda kohës prej 14 ditesh.
- 4 Mbasi rezultati është hedhur dhe pranuar në sistem, dhe ka kaluar afati kohor i 14 diteve, sistemi mbylli dhe komisioni nuk ka më të drejtë të bëjë ndryshim.
- 5 Në raste të jashtëzakonshme mbas këtij afati kohor, komisioni i paraqet një kërkesë me shkrim përgjegjësit të departamentit ku zhvillohet moduli për ndryshimin e notës së pretenduar dhe me miratimin e dekanit të fakultetit korrigohet nota në sistem nga IT e fakultetit. Prosesverbal i korrigjuar arshivohet në ZSS.
- 6 Mbasi hedhjes përfundimtare në sistem të notave, komisioni printon pasqyrën përfundimtare të rezultateve të provimit, i plotëson me firmat e nevojshme, e dorëzon në Departament, për tu përcjellë më tej, sipas hallkave deri në ZSS.

Neni 26

Ankimimi

- 1 Komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit në sistem në formën përfundimtare. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur.
- 2 Studenti ka të drejtë të ankohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit, ose nëse nuk është dakord me vlerësimin e bërë.
 - a. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit.
 - i. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda ditës së zhvillimit të provimit.
 - ii. Përgjegjësi i departamentit nëse verifikon shkelje të korrigueshme, në bashkëpunim me komisionin e provimit, bëjnë korrigjimet e duhura, duke vënë në dijeni Dekanin e FBM.
 - iii. Në rast se përgjegjësi i departamentit e gjykon se e ka të pamundur të marrë vendim, i propozon dekanit, i cili pasi është njohur me të gjithë procedurën merr vendim. Nëse ai e gjen të drejtë ankesën e studentit, anullon provimin dhe merr vendim për rizhvillimin e provimit.
 - b. Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit.
 - i. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit në momentin e mosrënies dakord me rezultatin e provimit.
 - ii. Përgjegjësi i departamentit, pasi konsultohet edhe me pedagogun e modulit, përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Vendimi i marrë i komunikohet studentit dhe për këtë informohet Dekani.
 - iii. Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje, atëherë me propozim të Përgjegjësit të Departamentit, Dekani vendos për ndryshimin e Komisionit dhe për ridhënien e provimit/kolokiumit brenda ditës ose të nesërmen pas përfundimit të tij.

Neni 27

Riprovimet dhe mbartja

- 1 Studenti në sistemin e studimeve me kohë të plotë i vlerësuar mbetës në dy sezonet e rregullta të provimeve (të dimrit dhe të verës), ka të drejtë:
 - a. Që në sezonin e vjeshtës të perdonë të gjitha datat e shpallura nga Fakulteti. Numri i provimeve të mundshme për tu shlyer në këtë sezon është **50%** e numrit total të moduleve të secilit vit akademik. Nese numri i moduleve te një viti akademik eshte tek, numri i datave te provimeve eshte $50\% + 1$.
 - b. Pas shpalljes së datave të provimeve të vjeshtës nga dekanati, studentët duhet të paraqesin kërkesën me shkrim pranë sekretarisë se departamenteve, ku të specifikohet moduli që kërkon të shlyejë dhe datën e shlyerjes së tij.
 - c. Numri minimal i krediteve për të kaluar në vitin akademik pasardhës, për të gjitha ciklet e studimit, përcaktohet në rregulloren e FBM
- 2 Për studentët përsëritës (viti pare dhe viti i dytë), ridhënia e provimeve për modulet e pashlyera, bëhet gjatë vitit në vazhdim, në sezonet e rregullta (dimrit dhe verës) dhe sezonin e vjeshtës të vitit që është shpallur përsëritës.
- 3 Studentët e vitit të fundit, (viti i dytë) që në përfundim të provimeve sezonit te fundit rezultojnë me 3(tre) module të pashlyera, kanë të drejtë t'i shlyejë ato dy javë para fillimit te sezonit të mbrojtjes së diplomave.
- 4 Studentët e vitit të fundit, (viti i dytë) që në përfundim të provimeve sezonit të fundit rezultojnë me më shumë se 3(tre) module të pashlyera, i shlyejnë ato në sezonet e rregullta dhe plotësuese të vitit në vazhdim, por jo në vjeshtë dhe diplomën e mbron në sezonet perkatese te diplomimit te atij viti.

Neni 28

Organizimi i praktikave profesionale

- 1 Kohëzgjatja dhe afati i praktikës profesionale përcaktohet në kurrikulat e Departamentit, i cili mban përgjegjësi për evidentimin e kompanive/institucioneve të mundshme për kryerjen e praktikës profesionale, si dhe krijimin e lidhjeve me to. Studenti mund t'i propozojë departamentit vendin ku mund të kryejë praktikën profesionale.
- 2 Departamenti harton rregulloren e praktikës profesionale, të cilën e miraton Dekani i FBM-së (Aneksi 2).

- 3 Praktikat profesionale zhvillohen në institucionë/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. Departamenti bën ndarjen e studentëve nëpër kompani/institucionë pritëse, duke respektuar edhe dëshirat e tyre. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës profesionale. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit pritës.
- 4 Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, punonjësi mësimor që e drejton atë, mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer e cila vlerësohet nga komisioni i ngritur nga departamenti për këtë qëllim, pasi merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë.
- 5 Studenti që nuk realizon programin e praktikës profesionale i nënshtrohet rregullave të vendosura si për të gjitha veprimtaritë e tjera formuese. Studenti merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet për realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale në terren.

Neni 29

Diplomimi i studentëve të programit programit të studimeve profesionale 2 vjeçare me provim formimi

- 1 UBT-ja organizon 2 sezone për provimet e formimit në verë, vjeshtë dhe dimër. Datat e zhvillimit të provimeve sipas sezoneve përkatëse, përcaktohen nga dekani i fakultetit.
- 2 Programi i provimit të formimit është i përgjithshëm, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Programi shpallet, në faqen e internetit të UBT-së, dhe u bëhet i ditur studentëve, sipas programit të studimit (Aneksi 3).
- 3 Provimi realizohet përpara një komisionit të posaçëm, të përbërë nga pedagogë të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamentet përkatëse dhe miratohen nga dekani. Kryetari i komisionit përgjithësisht është Përgjegjësi i Departamentit. Ai respekton në çdo rast, për secilin student procedurën dhe rregullat përkatëse të vendosura nga dekanati.
- 4 Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat që përfshihen në programin e provimit. Tezat e provimit të formimit hartohen nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe, firmosen nga përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani i fakultetit.

- 5 Provimi organizohet me gojë. Rregullat e tjera që kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit të provimit të formimit, përcaktohen në rregulloren e fakultetit. Rezultatet e provimit të formimit u jepen studentëve në fund të çdo dite provimi. Komisioni i provimit pret çdo reagim të studentit dhe e sqaron studentin në rast kontestimi. Nëse gjatë ballafaqimit konstatohet se është bërë gabim gjatë vlerësimit, bëhet ndryshimi i vlerësimit dhe mbahet një procesverbal.
- 6 Në përfundim të procesit të provimit, komisioni hedh rezultatet në sistem, printon procesverbalin i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Provimit, si dhe më pas nga personat e tjerë përgjegjës.

Anekset e kësaj rregulloreje

Aneks 1: Modeli i Syllabusit

Aneks 2: Udhëzues i Praktikave Profesionale

Aneks 3: Udhëzues i programit të Provimit të Formimit (*do përgatitet pas miratimit të programit te studimit*)

Aneks 4: Modeli i Diplomës dhe Suplementit

Aneks 1

Modeli i Syllabusit

PROGRAMI I LËNDËS: Hyrje në Akuakulturë

Titullari/pedagogu i lëndës: Prof. Asoc. Dr. Rigers Bakiu; Prof. Asoc. Dr. Elvira Beli

Ngarkesa: 6 ECTS, 4 orë/ javë; 60 (30:30)

Tipologjia e lëndës: Lëndë karakterizuese (B)

Viti Akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti i parë, semestri i dytë

Lloji i lëndës: E detyrueshme

Programi i studimit: Cikli i studimeve në program profesional 2 vjeçar, "Teknologjia e Akuakulturës dhe Peshkimit"

Kodi i lëndës:

Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës: rigers.bakiu@ubt.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Nëpërmjet programit të modulit "Hyrje në Akuakulturë", studentët do të fitojnë aftësitë dhe informacionin e nevojshëm për të arritur objektivat qe lidhen me aspektet mbi i) historine dhe rolin e akuakultures sebashku me karakteristikat e sistemeve te prodhimit ne fermat e akuakultures; ii) parimet mbi te cilat mbeshtetet funksionimi i nen-sektoreve te ndryshem te akuakultures, perfsheje ketu edhe akuakulturen e molusqeve bivalvor, iii) karakteristikat kryesore te fermave te kultivimit te peshkut duke perdorur pellgjet, raceway-it dhe koshat notues dhe iv) sistemet e mbyllur dhe ata te integruar sebashku si tendencat e fundit ne fushen e akuakultures.

Nëpërmjet programit të modulit studentët do të gjejnë informacionin e nevojshëm për një numër çështjesh të lidhura me rolin e akuakultures, historine e akuakultures, raportet e akuakultures me format e energjise, karakteristikat dhe kategorite e sistemeve te prodhimit ne akuakulture, funksionet dhe karakteristikat e gjithe sistemeve te akuakultures, moluskokultura dhe vleresimin i cilesise se molusqeve, metodat e vleresimit te cilesise se produkteve iqtike, koshat notues ne ujera e embel dhe ne zonat e mbrojtura detare (si gjiri detar), sistemet me rrjedhje te perhershme - Flow-through Raceways, pellgjet e akuakultures, sistemet e akuakultures me riqarkullim - RAS dhe akuaponiks - integrimi i kultivimit te bimeve dhe peshqve.

KONCEPTET THEMELORE

- Roli dhe rendesia e Akuakultures
- Marredhenia me format e ndryshme te energjise
- Funksionet dhe karakteristikat e gjithe Sistemeve te Prodhimit ne Akuakulture
- Kultivimi i molusqeve bivalvor dhe vleresimi i cilesise se moluseve
- Metodat e vleresimit te cilesise se produkteve iqtike

- Koshat notues te kultivimit te specieve me interes per Akuakulturen
- Sistemet Raceway (per kultivimin e troftes)
- Pelljet (per kultivimin e specieve te familjes e krapit)
- Sistemet e Akuakulture me Riqarkullim
- Sistemet e Integruar ne Akuakulture (Akuaponiks)

TEMAT E LËNDËS

ROLI I AKUAKULTURES:	
Tema 1	Kerkesat per Ushqimet me Origjine Detare; Sigurimi i Ushqimeve me Origjine Detare; Tregetia e Ushqimeve me Origjine Detare; Gjendja Aktuale e Akuakultures; Sistemet e Prodhimit; E Ardhmja dhe Sfidat. Ne literaturen e detyrueshme nga Faqja 23 ne Faqen 35.
HISTORIA E AKUAKULTURES:	
Tema 2	Origjina e Hershme e Akuakultures; Perhapja Eksponenciale e Perhapja Eksponenciale e Qendrave te Riprodhimit (<i>Hatchery</i>); Kur Arti Shnderrohet ne Shkencë; Peshku Mace; Tilapia; Peshqit e Sheshte; Salmoni i Atlantikut; Specie dhe Rajone te Rendesishme rrëth Zhvillimit te Akuakultures; Kultivimi i Karkalecave te Ujit; Moluskokultura; Polemika dhe Debate rrëth Akuakultures. Ne literaturen e detyrueshme nga Faqja 1 ne Faqen 14.
AKUAKULTURA DHE ENERGJIA:	
Tema 3	Energjia dhe Afesite Prodhuase; Akuakultura Ekstensive; Akuakultura Gjysme-Intensive; Akuakultura Intensive; Analiza e Tipeve te Akuakultures; Indeksi i Prodhimit; Zgjedhja e Llojit te Gjallesave dhe Tipit te Kultivimit.
KARAKTERISTIKAT DHE KATEGORITE E SISTEMEVE TE PRODHIMIT NE AKUAKULTURE:	
Tema 4	Sistemet e Hapur; Kultivimi i Bivalveve ne Vaska Pluskuese, Trare dhe Masa Trungjesh; Koshat dhe Rejetat Pluskuese; Sistemet Gjysme te Mbyllur; Raceway apo Kanale; Pellje; Sistemet e Mbyllur; Sistemet Biofilter Based; Sistemet Heterotrofike; Sistemet e Inegruar; Akuaponiks; In-pond raceways; Partitioned Aquaculture System. Ne literaturen e detyrueshme nga Faqja 51 ne Faqen 65.
FUNKSIONET DHE KARAKTERISTIKAT E TE GJITHE SISTEMEVE TE AKUAKULTURES:	
Tema 5	Ndryshimet midis Tufave Ujore dhe Tokesore; Sherbimet Ekologjike ne Sistemet e Prodhimit ne Akuakultura; Ndryshimet midis Kafsheve te Akuakultures dhe Atyre te Agrikultures; Klasifikimi i Kafsheve te Kultivuara ne Akuakulture sipas Temperatures;

	<p>Speciet e Ujerave te Ftohta; Speciet e Ujerave te Fresket; Speciet e Ujerave te Nxehte; Speciet Tropikale; Kontrolli i Temperatures ne Sistemet e Akuakultures; Sigurimi i Oksigenit ne Sistemet e Akuakultures; Oksigjeni ne Sistemet e Hapur; Oksigjeni ne Sistemet e Mbyllur; Kontrolli i Mbeturinave ne Sistemet e Akuakultures; Prodhim i Amoniakut nga Kafshet e Akuakultures; Amoniaku si Faktor Pengues ne Intensifikim; Kontrolli i Amoniakut ne Sistemet e Mbyllur; Bakteret Kemiautotrofik; Kontrolli i Amoniakut nga Bakteret Heterotrofike; Sistemet e Akuakultures si Sigurues te Ushqimeve Natyrore.</p> <p>Ne literatoren e detyrueshme nga Faqja 37 ne Faqen 48.</p>
Tema 6	<p>KULTIVIMI DHE MENAXHIMI I CILESISE SE MOLUSQEVE</p> <p>Speciet Kryesore ne Kultivim; Njohurite Baze per Kultivimin e Molusqeve; Depozitimi; Nacione rrith Praktikave qe Ndiken ne Nursery dhe Grow-out; Metodat ne Nursery; Kultivimi ne Nursery perfshin Sistemet e Pompave; Upwellers-at dhe Raceway-it; Metodat e Rritjes apo Grow-out; Rritja In-bottom apo On-bottom; Rafta dhe Carta (<i>subtidal apo intertidal</i>); Panelet Pluskuese Taylor dhe Rjetat Lantern; Fouling; Strategjite e Kontrollit te Fouling; Gjuajtja nga Grabitqaret; Mbledhja e Molusqeve; Siguria ne Ushqime; Semundjet e Molusqeve; Menyrat e Menaxhimit te Semundjeve; Shperthimet e Algave te Denishme; Zgjedhja e Vendit; Kapaciteti Mbajtes; Sfidat e Sektorit.</p>
Tema 7	<p>METODAT E VLERESIMIT TE CILESISE SE PRODUKTEVE IHTIKE:</p> <p>Metilaminat; acidet volatil; proteoliza dhe aminoacidet; pH; Indeksi refraktar i fluideve te syve; Aminat biogjenike; Aspektet lidhur me shendetin; Vleresimi i cilesise; Rregulloret dhe ceshtjet perkatese; Metodat e vleresimit sasior te aminave biogjenike.</p>
Tema 8	<p>KOSHAT NOTUES NE UJERAT E EMBEL DHE NE ZONAT E MBROJTURA DETARE:</p> <p>Gjendja Aktuale e Kultivimit me Kosha Notues; Historia dhe Evolucioni i Kultivimit me Kosha Notues; Avantazhet dhe Dizavantazhet; Zgjedhja e Vendit; Koshat e Stokimit; Te Ushqyerit e Peshqve ne Koshat Notues; Polikultura dhe Sistemet e Integruar; Problemet ne Kultivimin me Kosha Notues; Aspektet Ekonomike; Mbarevajja e te Tilla Sistemeve.</p> <p>Ne literatoren e detyrueshme nga Faqja 98 ne Faqen 109.</p>
Tema 9	<p>SISTEMET ME RRJEDHJE TE PERHERSHME - FLOW-THROUGH RACEWAYS:</p> <p>Speciet e Kultivuara; Tipet e Pellgjeve; Perdorimi i Ujit; Burimet; Humbjet; Perdorimi i Uji te Pellgjeve; Intensiteti i Kultivimit; Sherbimet Ekologjike; Ushqimi ne Pelljet e Akuakultures; Pleherimi i Pellgjeve; Pelljet ku Perdoret Ushqimi; Mbeshitetja e Jetesës ne Pelljet e Akuakultures; Oksigjeni i Tretur; Ajrimi Mekanik; Trajtimi i Mbetjeve; Perdorimi i Tokes dhe Impakti Ekologjik i Pellgjeve te Akuakultures; Konseguencat e Rritjes se Parregullit te Algave; Era e Keqe e Algave; Toksinat e Algave; Rregulla Praktike rrith Prodhibit te Pellgjeve te Akuakultures; Disporueshmeria e Rasatit te Peshkut; Sistemet e Prodhibit dhe Kerkesat e Tregut; Humbja e Prodhibit; Ekonomite</p>

	<p>Krahasuese te Sistemeve te Kultivimit; Mbarevajta, Tendencat dhe Nevojat per Kerkimin Shkencor.</p> <p>Ne literatoren e detyrueshme nga Faqja 166 ne Faqen 202</p>
Tema 10	<p>PELLGJET E AKUAKULTURES:</p> <p>Speciet e Kultivuara; Tipet e Pellgjeve; Perdonimi i Ujit; Burimet; Humbjet; Perdonimi i Uji te Pellgjeve; Intensiteti i Kultivimit; Sherbimet Ekologjike; Ushqimi ne Pellgjet e Akuakultures; Pleherimi i Pellgjeve; Pelljet ku Perdoret Ushqimi; Mbeshtetja e Jeteses ne Pellgjet e Akuakultures; Oksigjeni i Tretur; Ajrimi Mekanik; Trajtimi i Mbetjeve; Perdonimi i Tokes dhe Impakti Ekologjik i Pellgjeve te Akuakultures; Konseguencat e Rritjes se Parregullit te Algave; Era e Keqe e Algave; Toksinat e Algave; Rregulla Praktike rreth Prodhimit te Pellgjeve te Akuakultures; Disporimesheria e Rasatit te Peshkut; Sistemet e Prodhimit dhe Kerkesat e Tregut; Humbja e Prodhimit; Ekonomite Krahasuese te Sistemeve te Kultivimit; Mbarevaja.</p> <p>Ne literatoren e detyrueshme nga Faqja 166 ne Faqen 202</p>
Tema 11	<p>SISTEMET E AKUAKULTURES ME RIQARKULLIM - RAS:</p> <p>Atributet Pozitive; Aspektet Inxhinjerike te Sistemit; Vaskat e Kultivimit; Eliminimi i Mbetjeve te Ngurta; Basenet e Precipitimit dhe Vaskat; Filtrat Mekanik; Filtrat me Terren Granuloz; Konservimi i te Ngurtave; Biofiltrimi; Zgjedhja e Biofiltrave; Ajrimi dhe Oksigjenimi; Eliminimi i Dioksidit te Karbonit; Monitorimi dhe Kontrolli; Dizenzimi i Sistemit me Riqarkullim; Balancat e Mases; Ritmet e Karikimit; Rritja e Peshkut; Perzgjedhja e Vaskes; Njesia e Trajtimit te Ujit; Parametrat Kryesore te Trajtimit te Ujit; Parashikimi i Rritjes se Peshqve; Dendesa e Stokut.</p> <p>Ne literatoren e detyrueshme nga Faqja 205 ne Faqen 229</p>
Tema 12	<p>AKUAPONIKS - INTEGRIMI I KULTIVIMIT TE BIMEVE DHE PESHQVE:</p> <p>Projektimi i Sistemit; Prodhimi i Peshqve; Kultivimi Sekuencial; Ndarja e Stokut; Njesi te Shumefishta te Mbajtjes se Stokut; Te ngurtat dhe Eliminimi i Tyre; Biofiltrimi; Subsistemi Hidropnik; Rezervuari i Grumbullimit; Materialet e Ndertimit dhe Raportet e Komponenteve; Dinamikat e nutrienteve; Perzgjedhja e Bimeve; Kontrolli i Paraziteve dhe Semundjeve; Alternativat e Projektimit te Sistemeve; Aspektet Ekonomike; Prespektivat e se Ardhmes.</p> <p>Ne literatoren e detyrueshme nga Faqja 305 ne Faqen 333</p>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: 80%

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

